

RRJETI PËR ZHVILLIM RURAL I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

e-buletini

nr.02

dhjetor 2011

PUBLIKON

Rrjeti për zhvillim rural i
Republikës së Maqedonisë
www.ruralnet.mk
email: info@ruralnet.mk

"Orce Nikolov"
188-1/8 1000 Skopje
R. e Maqedonisë
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503



Në këtë
numër:

1. AKTIVITETE TË SHOQATAVE –
ANËTARE TË RZR TË RM-SË
2. ELARD
3. AKTIVITETE TË RËNDËSISHME TË
RZR TË RM-SË PËR VITIN 2011
4. MALLRAT PUBLIKE

Aktivitete të CEPROSARD
Aktivitete të PREDA PLUS
Aktivitete të ART POINT
Aktivitete të ETNO BEBA
Aktivitete të AGRO VINKA
Aktivitete të GRINER
Aktivitete të QENDRËS PËR
ZHVILLIM LOKAL – GJEVGJELI



Në dhjetor të vitit 2011, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë u bë anëtare e Shoqatës Evropiane LEADER për Zhvillim Rural (ELARD)



1. AKTIVITETE TË SHOQATAVE – ANËTARE TË RZR TË RM-SË

Aktivitetet të CeProSARD

Qendra për Promovimin e Praktikave të Qëndrueshme Bujqësore dhe Zhvillim Rural - CeProSARD në kuadër të projektit Agroenergji që është financuar nga Sida (Swedish International Development Cooperation Agency) filloi me vendosjen e pilot njësive (fermave). Pilot njësitet do të shërbejnë si qendra të vogla për trajnim në të cilat fermerët do të kanë mundësinë të njoftohen me teknologjinë dhe proceset që të shfrytëzojnë më mirë burimet ripërtirëse të energjisë nëpër fermat e viseve rurale si dhe përfitimet nga përmirësimi i efikasitetit energjetik.

- Janë vendosur dy kolektorë dielli për ujë të ngrohtë në fermë dele dhe lope
- Janë siguruar dy furra të peletave për dy sera moderne për prodhimtari të lules dhe kulturave kopshtare dhe pajisje për prodhimtarinë e peletave nga mbeturinat e zdrukthëtarisë.



- Janë vendosur kolektorë dielli për ujë të ngrohtë në shkollat e komunës Konçe.
- Në rrjedhë është ndërtimi i tharësës për produkte organike që do të punojë me shfrytëzimin e energjisë së diellit dhe energjisë së biomasës të mbetura nga lëvozhgat e bademeve, rrushit dhe shkopinjtë pemëve.
- Pastaj, vijon furnizimi i briketirses për kashtë.
- Gjatë vitit 2012, në pilot njësitet do të organizohen sesione edukative për grupet e ndryshme synuese.



Ekipi i CeProSARD gjatë periudhës prej shtator deri nëntor të vitit 2011 në kuadër të projektit Agroenergji ka zhvilluar punëtori në pesë qytete në Maqedoni në temën: Gruaja, burimet ripërtirëse të energjisë dhe efikasiteti energjetik.

Në sajë të këtyre evenimenteve ishte diskutuar për barazinë gjinore në fushën e burimeve ripërtirëse të energjisë, efikasiteti energjetik dhe kursimi në shtëpinë që zgjoi një interes të veçantë në publikun më të gjerë.

Punëtoritë u zhvilluan në:

- Shkup - Komuna Qendër - më 26. 09. 2011
- Shtip, 29.09.2011
- Manastir, 17.10.2011
- Strumicë, 31.10.2011
- Tetovë, 17.11.2011

Përfaqësuesit e CeProSARD si organizator të evenimentit i njoftuan të pranishmit me projektin Agroenergji dhe me temën e punëtorisë si një prej aktiviteteve në kuadër të këtij projekti.

Në punëtorinë kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të organizatave tjera të interesuara dhe institucione të shtetit: z-nja Elizabeta Spiridonova dhe z-nja Sanja Popovka Vasilevksa nga Organizata e Konsumatorëve e Maqedonisë (OKM) në temë: „Roli i gruas në kursimin e energjisë në shtëpi“, si dhe z-nja Valentina Stardelova dhe z-nja Milica Andonov nga Ministria e Ekonomisë në temë: „Burimet ripërtirëse të energjisë dhe efikasiteti energjetik në shtëpinë“.





Iniciativa të CeProSARD

Në përputhje me qëllimet të cilat kanë të bëjnë me ndihmën gjatë prezantimit dhe zbatimit të masave nga Bashkimi Evropian, Qendra për Promovimin e Praktikave të Qëndrueshme Bujqësore dhe Zhvillim Rural ka identifikuar nevojë për përfshirje më aktive në proceset ligjvënës që kanë lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm rural, posaçërisht në pjesën e burimeve ripërtirëse të energjisë dhe efikasitetit energjetik.

CeProSARD kanë bërë analiza të rregulloreve që kanë të bëjnë me prodhimtarinë e energjisë nga burime ripërtirëse në pjesën e prodhimtarisë së energjisë nga biomasa.

Fokusi i analizës ishte vendosur mbi prodhimtarinë e kulturave të cilat shërbejnë për fitimin e energjisë nga biomasa, vëllimi dhe përfshirja e tokës që do të përdoret për këtë qëllim, si dhe prezantimi i akteve në nivelin lokal që do të përfshijnë përmirësimin e planifikimit të zhvillimit lokal rural.

Ideja është në pajtim me ndryshimet, sfidat dhe pasojat me të cilat përballohet Bashkimi Evropian në të cilën edhe me zbatimin e rregulloreve ligjore që kanë të bëjnë me burimet ripërtirëse të energjisë dhe efikasitetit energjetik, sërish paraqiten mangësi në kuptimin e mbrojtjes së llojllojshmërisë biologjike dhe administrimin e mirë me tokën.



CeProSARD gjatë punëtorisë që u mbajt në Shkup më 22.11.2011 në hotelin Arka i prezantoi zbulimet nga analiza dhe ishte shprehur mendimi për analizën në fjalë nga ana e gjithë aktorëve relevant: ministritë, agjencitë, organizatat joqeveritare, pushtetet lokale, të cilat çdo ditë përballohen me këto çështje dhe mund të kontribuojnë për procesin. Në punëtorinë ishin të pranishëm edhe 12 deputetë nga grupet ndryshme parlamentare dhe komisione.

Kjo iniciativë ka për qëllim të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm në viset rurale në Maqedoni me anë të sigurimit të kushteve përkatëse për shfrytëzimin më të madh të energjisë të fituar nga burimet ripërtirëse. iniciativa është mbështetur nga Instituti Kombëtar Demokratik në Maqedoni.



Aktivitete të PREDA PLUS

Rëndësia e politikës për zhvillimin rajonal në shtetet e Ballkanit Perëndimor



Në organizim të Fondacionit për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik PREDA Plus, në hotelin Continental, Shkup, më 23 nëntor ishte organizuar Konferenca e Parë Ndërkombëtare për Zhvillim Rural të Ballkanit Perëndimor 2011.

Në konferencën kanë marrë pjesë 100 pjesëmarrës, përfaqësues të komunave, agjenci për zhvillim ekonomik, rajonal dhe rural, krijues të politikave, ministri, ambasadorë dhe praktikantë nga shtetet e ndryshme: Maqedoni, Shqipëri, Kosovë, Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Kroaci. Ata kanë prezantuar gjendjen në shtetet e tyre nga perspektiva të ndryshme si dhe shqyrtimet e tyre për zhvillimin rajonal dhe bashkëpunimin mes shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Në organizim të Fondacionit për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik PREDA Plus, në hotelin Continental, Shkup, më 23 nëntor ishte organizuar Konferenca

Gjatë konferencës, në të cilën kishte shumë propozime konstruktive për përmirësimin e zbatimit të politikës për zhvillim rajonal, ishte përfunduar që kjo politikë për qeveritë kombëtare të secilit shtet është segment i rëndësishëm dhe koncept për zhvillim të mëtutjeshëm. Pikërisht për atë, qeveritë kombëtare të secilit shtet në veçanti duhet të japin më tepër mbështetje politikave për zhvillim rajonal për shtetin e tyre por edhe për zhvillimin e rajonit.

Politika e tillë për shtetet e Ballkanit Perëndimor është fort e mbështetur edhe nga bashkësia ndërkombëtare sepse zhvillimi rajonal është një prej koncepteve themelore për zhvillim të vetë Bashkimit Evropian.

Si konkluzion i rëndësishëm nga kjo konferencë ishte theksuar edhe nevoja dhe rëndësia e rrjetëzimit të përbashkët të gjithë aktorëve relevant për zhvillim rajonal për Ballkanin Perëndimor. Pritet së shpejti zyrtarizimi i këtij procesi.

Konferenca e radhës ndërkombëtare mbi temën e zhvillimit rajonal është caktuar për vitin e ardhshëm në Kosovë.



Aktivitetet të ART POINT – GUMNO

Më 18 nëntor 2011 studentët e Akademisë për Arte Vizuale pranë Universitetit në Karolinën Veriore, SHBA, në mënyrë solemne e hapën ekspozitën me vepra të inspiruar nga jeta në Slloeshticë. Grupi prej 10 studentëve dhe profesoresha e tyre Pamela Wallace Toll kanë qëndruar në Maqedoni gjatë muajit qershor të këtij viti dhe kanë pasur mundësinë që gjithë kohën e qëndrimit të tyre të jetojnë nëpër familje në fshatin Slloeshticë, ku si mysafirë të Qendrës Ndërkombëtare për Arte dhe Zhvillim të Qëndrueshëm Art Point – Gumno e kanë realizuar projektin „Macedonia live“.

Gjithashtu, profesoresha Pamela Wallace Toll, e cila njëherë është edhe artiste me renome, ka marrë pjesë në një seminar me titullin “Rezidenca për bashkëpunim” (“Collaborative residences”) e cila ishte mbajtur në Savannah College of Art And Design (SCAD), Karolina Veriore, SHBA. Toll bëri një prezantim për Art Point - Gumno, dhe ka promovuar programin për rezidenca ndërkombëtare artistike dhe përvojën e saj të dytë si artiste rezidenciale në Qendrën e cila gjendet në fshatin Slloeshticë.



Aktivitetet të ETNO BEBA

Shoqata “EKO-GARD” “ETNO BEBA” BL f. Rezhanovcë

Manifestim ekonomiko-turistik dhe kulturor

“PRAZIJADA 2011” e organizuar në f. Rezhanovcë më 12.11.2011 nga ana e shoqatës “EKO-GARD” “ETNO BEBA” BL f. Rezhanovcë nën patronazhin e Kryetarit dhe Këshillit të Komunës së Kumanovës dhe mbështetur nga Sida dhe RZR – RM-së.

Manifestimi PRAZIJADA 2011 është manifestim ekonomiko-turistik dhe kulturor e cila për herë të parë mbahet në rajonin e Kumanovës dhe më gjerë. Qëllimi kryesor i manifestimit është promovimi i këtyre viseve si një rajon i volitshëm për prodhimtarinë e prasi si ushqim ekologjik i shëndoshë dhe nxitjen e potencialeve për prodhimtari më të zmadhuar.

Aktivitetet e parashikuara me programin e manifestimit do të kontribuojnë për promovimin e kulturës dhe zakonet e popullatës së këtij rajoni si dhe për kujdesin e traditave që vazhdimisht po harrohen. Gara për ushqimin më të mirë të përgatitur nga prasi dhe pjesëmarrja e rëndësishme e grave rurale në manifestimin do të jep një impuls plotësues për përfshirjen e tyre të mëtutjeshme në rrjedhat shoqërore.

Aktivitetet sportive dhe kulturore-argëtuese do të mundësojnë bashkëpunim më të madh dhe afim të rinisë nga fshatrat e rajonit. Prezenca e një numri të madh të pjesëmarrësve dhe mysafirëve do të promovojnë rajonin si një resurs të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit fshatar.





Aktivitetet të AGRO VINKA

Shoqata për Zhvillim Rural „JAVOR“ – Komuna e Zërnovcit

Më 22 dhe 23 dhjetor 2011, Shoqata për Zhvillim Rural „Javor“, nga komuna e Zërnovcit, ka organizuar punëtori praktike dyditore për nxënësit e SHF „Sinisha Stoilov“ nga Zërnovci, me titullin „Rruga e leshit“, gjatë të cilës ata u njoftuan me teknologjinë e fitimit të leshit dhe në mënyrë praktike kanë punuar në përpunimin e përkujtimeve nga leshi me a.q. flic teknologji të përpunimit të leshit natyror.



Trajnimin e kanë zhvilluar anëtarë të Shoqatës së Fermerëve Gra „Agro-Vinka“ nga Vinica.

Këto aktivitete janë pjesë e projektit me titull „Popullata e re e edukuar ekologjikisht – shtytës i zhvillimit rural në bashkësinë“.

Projekti parashikon promovim të zhvillimit të qëndrueshëm në arsim me anë të përdorimit dhe praktikimit të pakos multimediale për arsim të qëndrueshëm. Pakoja e Gjellbër në SHF „Sinisha Stoilov“ nga Zërnovci dhe shkollën rajonale në fshatin Mordavis.

Me aktivitetet e projektit do të përfshihen 126 nxënës nga klasa e parë deri në pestë, prindërit e tyre, popullata e komunës së Zërnovcit dhe bashkësia më e gjerë. Qëllimi i projektit është të krijojë praktika ekologjike me nxënësit dhe mësime dhënësit e tyre në programin mësimor, të cilat janë të qëndrueshme ekonomike dhe social dhe sigurojnë vazhdimësi të arsimit ekologjik me sigurimin e pjesëmarrjes aktive të bashkësisë në zgjedhjen e problemeve ekologjike dhe zhvillimin e iniciativave të qëndrueshme që do të kontribuojnë për zhvillimin e mjediseve rurale.



Në kuptimin afatgjatë, projekti do të mundësojë krijimin e kushteve për zhvillim rural të komunës me anë të arsimit ekologjik të popullatës më të re, posaçërisht për zhvillimin e turizmit fshatar dhe agrar, mirëmbajtja e epititet „eko fshat“ si një prej drejtimeve më kryesore për zhvillim të komunës të parashikuar në Strategjinë për Zhvillim Rural dhe ZHLE të komunës së Zërnovcit

Bartës i projektit është Shoqata për Zhvillim Rural „Javor“ nga Zërnovci ndërsa partnerë janë:

- Shkolla Filllore „Sinisha Stoilov“ nga Zërnovci
- Pushteti Lokal i Komunës së Zërnovcit
- NPK „Vodna Kulla“ nga Zërnovci dhe
- Shoqata e Fermerëve Gra „Agro-Vinka“ nga Vinica.

Projekti është financuar nga QRE (Qendra Rajonale Ekologjike – zyra në Shkup), me mjetet nga bashkëpunimi austriak për zhvillim, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimi Hapësinor i RM-së dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës e RM-së.





Aktivitetete të GRINER

Shoqata për Shoqëri të Gjellbër GREENER

„Go Clean“ – Fushatë për grumbullimin e baterive të vjetra



Gjatë kohëve të fundit, Shoqata për Shoqëri të Gjellbër Greener, në partneritet me shoqatat qytetare Go Green dhe 4x4x4 Ura Ballkanike kanë filluar realizimin e projektit „Go Clean“. Projekti është mbështetur nga Ambasada e Suedisë në Republikën e Maqedonisë dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikim Hapësinor e Republikës së Maqedonisë, ndërsa përkrahur nga Ambasadat e Norvegjisë dhe Republikës së Sllovakisë në Republikën e Maqedonisë. Si bashkëpunëtorë në projektin janë përfshirë SEPA (Swedish Environmental Protection Agency) dhe OHO. Vend të posaçëm në projektin kanë edhe marketet KAM, RAMSTORE, TINEKS dhe VERO (ku edhe do të vendosen shportat speciale për grumbullimin e baterive të përdorura nga qytetarët) dhe kompania për riciklim dhe përpunim të akumulatorëve VESNA SAP nga Probishtipi, e cila do të bëjë eksportin e baterive të grumbulluara.

Projekti „Go Clean“ ka për qëllim të mbështet zbatimin e Ligjit për Administrimin me Baterie dhe Akumulatorë dhe Bateria dhe Akumulatorë të Vjetër („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. 140/10, 47/11) i cili zbatohet prej 1 janar 2011 dhe të mundësojë krijimin e një sistemi për administrimin e baterive të vjetra.

Fillimi i projektit ishte shënuar më datën 08.11.2011 në EU Info Qendrën në Shkup me zhvillimin e seminarit me temën „Administrimi me bateritë e vjetra në shtetet e Bashkimit Evropian dhe ligjet relevante në Republikën e Maqedonisë“. Ky eveniment kishte për qëllim të ngrit vetëdijen mbi administrimin me baterie të vjetra, riciklim dhe krijim të strukturave përkatëse për zbatimin e Ligjit Administrimin me Baterie dhe Akumulatorë dhe Bateria dhe Akumulatorë të

Vjetër. Gjatë seminarit u drejtuan z Abdulaqim Ademi, Ministër i Mjedisit Jetësor dhe Planifikim Hapësinor i Republikës së Maqedonisë, z Lars Vahlund, Ambasador i Suedisë në Republikën e Maqedonisë, Dr. Snezhana Stojkovska (e cila sqaroi për ndikimin negativ të përbërjes së baterive mbi shëndetin e njerëzve dhe mjedisin jetësor), z Lars Eklund, ekspert nga Agjencia Suedeze për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor (i cili i prezantoi përvojat nga praktikatat e zbatuara në shtetin e tij) dhe Udhëheqësi i Sektorit për Administrim me Mbeturina, z-nja Ana Karanfillova Mazneva.

Në seminarin ishin prezantuar edhe shportat speciale për baterie të vjetra që do të përdoren gjatë fushatës së grumbullimit të baterive dhe do të vendosen në marketet që janë pjesë e projektit, në territorin e Shkupit, Kumanovës dhe Tetovës, duke filluar prej më datën 01.12.2011.

Projekti vazhdoi me realizimin e Seminareve për të Rinj më 12.11.2011 në Fakultetin Ekonomik në Shkup. Kjo është pjesë e fushatës së planifikuar për edukim të rinisë dhe fushatë kombëtare për grumbullimin e baterive të vjetra. Pushtetet lokale kanë rolin kryesor në përfshirjen e shkollave dhe ngritjen e vetëdijes së popullatës, si dhe për themelimin e pikave për grumbullim që qytetarët të mund të hedhin bateritë e vjetra dhe zbrazëta. Fushata për grumbullimin e baterive të zbrazëta është e mbuluar nga mediet si gazeta ditore VEST dhe nga radio Antena 5 ndërsa për pjesën e reklamimit është kujdesur kompania AKCENT Media e cila gjithashtu është bashkëpunëtorë e projektit.

Të gjitha informatat lidhur me projektin mund të gjenden në faqen e Go Clean në Facebook.





Aktivitetet të QENDRËS PËR ZHVILLIM LOKAL – GJEVGJELI

Ishte hapur byro informative në Gjevgjeli për këshillime në fushën e burimeve ripërtirëse të energjisë dhe efikasitetit energjetik



Në kuadër të projektit “Bashkëpunimi Ndërkufitar në Fushën e Burimeve Ripërtirëse të Energjisë dhe Efikasiteti Energjetik” të cilin Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Zhvillim të Teknologjive Informatike nga Gjevgjelia e zbaton bashkë me aleancën e prodhuesve të energjisë ekologjike – BG nga Bllagovegradi, Bulgaria, u hap dhe filloi me punë një Byro për Konsultime Këshilluese dhe Informative nga fusha e burimeve ripërtirëse të energjisë (BRE).

Byroja gjendet në adresën „Marshall Tito” nr. 60 në Gjevgjeli, ku është edhe selia e Projektit, dhe të gjithë

palët e interesuar mund të vizitojnë Byronë.

Konsultimet zhvillohen nga një ekspert i energjetikës dhe janë falas. Përgjigjet e pyetjeve dorëzohen në formë me shkrim, në postë elektronike.

Subjektet e interesuar mund të marrin informata nga fusha e ligjeve që trajtojnë energjetikën në RM, për procedurat administrative gjatë investimit në sektorin e BRE-së, për teknologji që përdoren në BRE, të dhëna për kompanitë nga R e Bullgarisë dhe R e Maqedonisë të cilat punojnë në sferën e BRE-së, si dhe subvencionet financiare për BRE.

Numrat telefonik për kontakt janë +389 34 215941, +389 78 32709.

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian dhe Republika e Maqedonisë në kuadër të programit ndërkufitar Bullgari – Maqedoni IPA Cross-Border Programme CCI number 2007CB161PO007.

2. ELARD

Në dhjetor të vitit 2011, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë u bë anëtare e Shoqatës Evropiane LEADER për Zhvillim Rural (ELARD)

ELARD është shoqatë ndërkombëtare joprobitabile, e krijuar për të përmirësuar cilësinë e viseve rurale dhe të mbajë popullatën e tyre me anë të zhvillimit të qëndrueshëm reciprok rural të integruar. Gjatë detyrës së saj, ELARD lufton për përhapjen e filozofisë së LEADER metodës në nivelin lokal dhe në nivelin institucional. ELARD është themeluar në Belgjikë më 1999 nga LEADER rrjetet kombëtare të aksion grupeve lokale AGL të Francës, Greqisë, Irlandës, Italisë dhe Spanjës. Në momentin më tepër se 600 aksion grupe lokale janë përfshirë nëpërmjet rrjeteve kombëtare, rajonale dhe si anëtarë individual.

Sot, anëtarët e ELARD vijnë nga këto 21 shtete: Kroacia, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Hungaria, Italia, Irlanda, Letonia, Lituania, Republika e Maqedonisë, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë.

ELARD për momentin punon në zgjerimin e anëtarë-



sisë ende më tutje, posaçërisht me shtetet e reja anëtare dhe shtetet që janë para hyrjes në Bashkimin Evropian, për të krijuar një front të llojllojshëm kulturor dhe kombëtar të anëtarëve të bashkuar me një qëllim të përbashkët të krijimit të një Evrope rurale të qëndrueshme. Shoqata është e obliguar të përfshijë gjitha faktorët e zhvillimit lokal rural.

ELARD në mënyrë të drejtpërdrejtë i mbështet anëtarët e saja gjatë përpjekjeve të tyre për projekte inovative në fushën e zhvillimit rural si dhe në përpjekjet për rrjetëzim për bashkëpunim dhe zgjerim të përvojave pozitive dhe njohurive prej një territori në tjetrën.

Gjithashtu, ELARD i përfaqëson edhe interesat dhe nevojat e anëtarëve të saja para institucioneve tjera ndërkombëtare, evropiane dhe kombëtare. Ai është i njohur nga Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (DG AGRICULTURE) si një shoqatë që përfaqëson aksion grupet lokale në nivelin evropian dhe është e pranuar në Rrjetin Evropian për Zhvillim Rural (REZR) në pajtim me rregulloret e reja për zhvillim rural 1698/05 me pjesëmarrjen e saj në Këshillin Drejtues të REZR dhe Nënkëshillin e LEADER.

Shoqata në mënyrë aktive punon edhe për të bërë LEADER metodën më të njohur në mesin e faktorëve relevant evropian për të mbajtur pozitën e saj si pjesë kryesore e politikës evropiane për zhvillim rural.



3. AKTIVITETE TË RËNDËSISHME TË RZR TË RM-SË PËR VITIN 2011

AGROFUD

Llojlojshmëri, rrjetëzim dhe qasja LEADER në rajonet rurale

Në kuadër të panairit Agrofud, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë dhe Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim Humanopolis (anëtare e Grupacionit ERA Skopski Saem) vitin e dytë me radhë kanë organizuar forum për zhvillimin rural në temën “Llojlojshmëri, rrjetëzim dhe qasja LEADER në rajonet rurale”.

Qëllimi i forumit ishte të përcillen dhe shpërndahen përvojat nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian mbi këto tema të cilat janë të lidhura ndërmjet dhe janë një prej parakushteve kryesore për zbatimin e politikave dhe programeve për zhvillim rural.

Në fillim, fjalim bëri kryetari i RZR-së, z. Petar Gjeorgievski duke theksuar rëndësinë e këtyre tre temave, me fillim në llojlojshmërinë e mjediseve rurale e cila kontribuon për rritjen e aktivitetit ekonomik, duke siguruar mundësi dhe duke krijuar ekonomi më të qëndrueshme dhe më të baraspeshuar. Ai foli edhe për rëndësinë e rrjetëzimit, si potencial për vendosjen dhe themelimin e bashkëpunimit mes individëve dhe grupeve të ndryshme në viset rurale dhe në fund u përqendrua në qasjen LEADER, si një metodë që synon përmirësimin e zhvillimit ekonomik lokal duke promovuar partneritete dhe zbatim të strategjive lokale zhvillimore me parimin prej poshtë nga lartë, duke filluar nga nevojat e popullatës rurale.

Gjatë forumit, me prezantime të veta kanë marrë pjesë ekspertë dhe përfaqësues të organizatave për zhvillim rural nga shtetet e Bashkimit Evropian. Përfaqësuesi nga Rrjeti Evropian për Zhvillim Rural (REZR) ishte z. Fabio Kosu, i cili diskutoi për dobinë e rrjetëzimit dhe bashkëpunimi për zhvillimin rural. Gjithashtu, në forumin prezantim kishte edhe z. Patras Panajotis, përfaqësues i LEADER Shoqatës Evropiane ELARD dhe kryetar i Agjencisë Zhvillimore nga Trikala – Greqi. Ai kryesisht u përqendrua në vlerën e shtuar të metodës LEADER dhe arritjet për rigjallërimin e viseve rurale në Evropë si dhe rrjetëzimin e LEADER grupeve në nivel të BE-së.

Gjithashtu, me prezantim morri pjesë edhe drejtori ekzekutiv i Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, z. Dimçe Mitreski, si përfaqësues i organizatave qytetare maqedonase të cilat punojnë në fushën e zhvillimit ekonomik rural. Ai i përcolli përvojat për gjetjen e zgjidhjeve për përmirësimin e kushteve të jetës në mjediset rurale në Republikën e Maqedonisë.

Në forumin kanë marrë pjesë anëtarët e RZR si dhe përfaqësues të organizatave që punojnë në fushën e zhvillimit rural.





PEHCEVO

Në kuadër të grupit tematik për përforsim ekonomik të grave nga viset rurale, RZR i RM-së në shtator 2011 ka organizuar një trajnim njëditësh për gratë të përkatësisë rome nga komuna e Pehçevës. Qëllimi i trajnimit ishte të trajnohen në përpunimin e artikujve nga leshi, me flic teknike për përpunimin e leshit. Trajnimin e ka zhvilluar shoqata e grave për thurje Serafim nga Berova, gjatë së cilës ishte bërë transferimi i njohurive dhe shkathtësive për këtë punë.

DITA NDËRKOMBËTARE E GRUAS RURALE

Hatixhe Iseini, Katerina Rizhova, Zhelka Dikliq Ilievski, Nikolina Bozhinova, Radojka Qoropanovska janë pesë gratë më të suksesshme – fermerë të cilat këtë vit morën falënderime nga Federata e Fermerëve e RM-së gjatë shënimit solemn të Ditës ndërkombëtare të gruas rurale, që u mbajt për herën e katërt ndërsa për herë të parë në Tetovë. Manifestimi është mbështetur edhe nga Rrjeti për Zhvillim Rural dhe Ceprosard.

- Ndonëse kjo është një ditë e vitit, sërish gruaja rurale meriton afirmim më të madh duke marrë parasysh se ajo është shtylla e familjes, e cila kujdeset për fëmijët, për ushqimin, për shëndetin e familjes, për fermën dhe ajo që mua personalisht më gëzon në kohën e fundit është se ka mundësinë të shpreh shkathtësitë dhe aftësitë e saja. Ajo që më brengos është përfshirja e vogël e grave në shoqërimin bujqësor dhe aktivitete në të cilat arrihen vendime për zhvillimin e bujqësisë. Duke i njohur gratë si të vendosura, zbatuese dhe bisedues të mirë, dua t'ju nxis që të jeni më tepër të përfshirë në biznesin dhe në krijimin e politikave në bujqësi sepse ashtu do të përfitojë edhe gjithë shoqëria jonë. Bashkohuni dhe tregoni që keni zë, të drejtë, fuqi për të qenë liderë të vërtetë dhe shtytës të procesit bujqësor – theksoi Nedim Kasami, zëvendës kryetar i FFRM.

- Kërkoni të drejtën e juaj, përdorni shkathtësitë personale dhe punoni bashkë, porositi Titi Jungren nga Federata Suedeze e Fermerëve Gra.

Sipas saj, si burrat ashtu edhe gratë duhet të marrin përgjegjësi të barabartë gjatë organizimit bujqësor për të arritur qëndrueshmëri në çdo aspekt, ekonomik, ekologjik dhe social.

Pjesëmarrësit në manifestimin kishin mundësinë të degustojnë ushqime tradicionale shtëpiake të përgatitur nga gratë rurale të RM-së.

Në botë ka rreth 1.6 miliardë gra rurale, që është mbi një e katërt e popullatës së përgjithshme. Mesatarisht prodhojnë mbi gjysmën e gjithë ushqimit, deri më 80% në Afrikë, 60% në Azi, 30-40% në Amerikën Jugore dhe shtetet perëndimore. Posedojnë vetëm 2% të tokës, marrin vetëm 1% të kredive bujqësore dhe për ata janë synuar vetëm 5% të mjeteve për mbështetje të drejtpërdrejtë në bujqësi.





INFORMIMI PËR QASJEN LEADER



“Informimi për qasjen LEADER” është një projekt që ishte realizuar në nivelin kombëtar duke organizuar forume njëditëshe në 8 rajonet e planifikimit të Republikës së Maqedonisë. Projekti realizohej në bashkëpunim dhe me mbështetjen financiare të Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar – MCMS.

Zbatimi i projektit ishte zhvilluar me anë të organizimit dhe realizimit të forumeve njëditëshe – të orientuar drejt informimit të palëve të interesuara – pjesëmarrësit, për qasjen LEADER, për parimet dhe metodologjinë, konceptin e tij – themelimi i Aksion Grupeve Lokale – AGL dhe udhëheqja me aktivitetet e lidhura me zhvillimin rural. Informata e siguruar dhe prezantuar gjatë forumeve kishte për qëllim të sigurojë publikut mundësi konkrete për të marrë informata dhe paranjohuri për LEADER si bazë dhe përfshirje më të mirë të publikut në përgatitjen për prezantimin e LEADER si IPARD masë nga ana e Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Administrim të Ujit në vitin 2012.

Secili prej forumeve në mënyrë tematike ishte organizuar në tre pjesë:

1. Pjesa hyrëse

Sqarim i qëllimit për organizimin e forumit dhe informimi hyrës për LEADER qasjen dhe parimet e saja dhe qëllimet e pushtetit qendror për prezantimin si masë për zhvillimin rural, në kuadër të IPARD programit.

2. Prezantimi tematik

Sqarim për rëndësinë e LEADER në zhvillimin rural dhe themelimin e LEADER metodologjisë dhe shtatë (7) parimet e saja gjatë zbatimit të aktiviteteve të integruara për zhvillim të rajoneve rurale. Më tutje, ishte prezantuar historia e LEADER dhe prezantimi i saj si bosht në politikën e BE-së për zhvillim rural dhe masë e detyrueshme në kuadër të kësaj politike. Gjithashtu, ishin prezantuar edhe përvojat pozitive nga simulimi i LEADER qasjes në 16 komuna në Republikën e Maqedonisë, lidhja e RZR i RM-së me LEADER. Gjatë prezantimit pjesëmarrësit ishin të informuar për propozim versionin e përgatitur të Strategjisë për Prezantimin e Masës LEADER në kuadër të IPARD programit 2007-2013 (Masa 202) nga ana e MBPAU-së dhe hapat e mëtejshme që duhet të ndërmerren nga organet relevante.

Pjesa përfundimtare

Diskutim me pjesëmarrësit e forumit mbi temat e forumit në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve.

Projekti ishte realizuar në periudhën tetor-dhjetor 2011. Forumet u realizuan në tetë rajonet e planifikimit (Shkup, Vardar, Verilindor, Lindor, Juglindor, Pellagonik, Jugperëndimor dhe rajonin e Pollogut).

Grupet synuese të projektit ishin palët e interesuar – përfaqësues (personat fizik dhe juridik) nga: sektori afarist, publik dhe qytetar.





MALLRAT PUBLIKE

Mallrat publike luajnë rol të rëndësishëm si pjesë themelore në zhvillimin afatgjatë të viseve rurale. Kjo ka të bëjë me zmadhimin e pasurive kulturore, historike, njerëzore dhe pasuritë e mjedisit jetësor dhe promovimin e rolit të tyre për avancimin e rritjes së qëndrueshme socio-ekonomike. (Burim: Rrjeti Evropian për Zhvillim Rural).

Përcaktimi i mallrave publike në viset rurale evropiane mund të ketë ndikim të madh mbi stimulimin e zhvillimit ekonomik. Kjo në veçanti është e rëndësishme në raste të mallrave publike që kanë të bëjnë me bujqësinë, siç janë gjallërimi ekonomik dhe social i viseve rurale, furnizimi me produkte ushqimore dhe trajtimi më i mirë i mundshëm i bagëtisë në fermat. Produktet lokale tradicionale ose turizmi lokal mund gjithashtu të kontribuojnë për plotësimin e veçorive të përgjithshme të një rajoni, për shembull, peizazhet e bukura natyrore, ajri i pastër dhe toka e pastër nga ndotja ose llojlojshmëria biologjike specifike për rajonin. Këto veçori mund të luajnë rol kryesor për tërheqjen e investimeve dhe promovimin e aktiviteteve ekonomike të cilat më tutje do të kontribuojnë për përmirësimin e ekonomisë rurale lokale dhe me këtë edhe cilësinë e jetës në bashkësinë. Disa rajone rurale janë të varura ekonomikisht, pjesërisht ose tërësisht, nga rrethina e tyre natyrore ndërsa përcaktimi i këtyre mallrave publike mund të ndërlidhet në masë të madhe me mbrojtjen e rrethinës së tyre natyrore duke ndërmarrë hapat të caktuara bujqësore. Programet për zhvillim rural të shteteve anëtare të BE-së ofrojnë mbështetje gjatë promovimit të bujqësisë së vetë-qëndrueshme, përmirësimin e cilësisë së jetës në viset rurale dhe nxitjen e llojlojshmërisë së aktiviteteve ekonomike. Shumë prej këtyre aktiviteteve ndihmojnë zhvillimin e infrastrukturës rurale dhe krijimin e shërbimeve të reja dhe produkteve që krijojnë pasuri të veçanta natyrore. Duke ndihmuar në mbijetesën e masës kritike të popullatës së viseve rurale, këto aktivitete kontribuojnë për përmirësimin e gjallërimit social dhe cilësisë së jetës në atë rrethinë.

Vizita në fermën Kler (Claire Farm Heritage) në Buren, Irlandë

Rajoni Buren, në pjesën Kler, Irlandë është një prej panoramave më unike në Irlandë dhe Evropë, me pllaka enorme të gëlqeres, e prerë për mrekulli në të çara. Vendi është i pasur me pamje mahnitëse, histori antike, faunë dhe kulturë spektakulare. Shumë rajone në Buren janë të shpallura si vende konservate, të mbrojtura me Direktivën për Mbrojtje të BE-së ndërsa një pjesë e trashëgimisë së mrekullueshme historike dhe kulturore e Buren gjendet në fermat private, në të cilat ndalohet qasja ndërsa puna mbi fermat është e kufizuar. Në 2009, disa fermerë lokal u mbledhën dhe vendosën me bashkëpunim të përbashkët t'i bëjnë ata vende të gatshme edhe për vizitorë. Të gjithë fermerët vazhduan me traditën e vjetër mbi 6000 vjeçare të përpunimit të tokës mbi të cilën ishin zbuluar mbi 100 vende arkeologjike dhe kujtime dhe ku shumë prej peizazheve kanë mbetur të pandryshuar me milionë vite. Për të përfituar nga kjo trashëgimi, Korporata Claire Farm Heritage Tours ishte themeluar nga 9 fermerë të Kler-it verior. Qëllimi i kësaj korporate është i dyfishtë: llojlojshmëri të aktiviteteve të vetë fermave dhe zhvillim të ofertave të reja turistike që do të mund të tërheqin interes të madh dhe dobi afatgjate për komunitetin e Rajonit Kler. Me mbështetjen e boshtit 4 të Rrjetit Irlandez për Zhvillim Rural, korporata i filloi aktivitetet e saja në vitin 2009. Claire Farm Heritage Tours është anëtare e Rrjetit për Ekoturizëm të Buren-it dhe ka punësuar banorë lokal për promovimin e trashëgimisë, arkeologjisë dhe përvojat antike bujqësore, duke i edukuar turistët për ndjeshmërinë e pamjeve në Buren dhe rëndësia e mbrojtjes së saj. Turistët në kohën e njëjtë mësojnë dhe argëtohen ndërsa vizitorët i udhëheqin persona të cilët kanë jetuar dhe punuar në Buren me gjenerata. Ky projekt është shtrirë vetëm një orë distancë nga aeroporti ndërkombëtar Shannon dhe ka efekt pozitiv ekonomik mbi rajonin përreth sepse sjell më tepër vizitorë në rajonin Kler dhe hap vende të punës për fermerët lokal. Ky është një shembull si krijimi i mallrave publike në rrethinën e njeriut me anë të bujqësisë mund të jetë bazë për mundësi më të mëdha për zhvillim rural. Ky projekt gjithashtu ndihmon edhe në krijimin e një ndjenje më të madhe për kontribut në kuadër të bashkësisë lokale. Projekti ka hyrë në finalen e garës në inovacione nga fusha e biznesit rural për vitin 2010. Për më tepër informata, vizitoni ueb faqen www.farmheritagetours.com

